



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-120558/21 dt. 25.06.2021, të investitorit “Lirimi & ACL” me certifikatë të regjistrimit ARBK 810821860 me seli në Prishtinë me përfaqësues Hysen Haxhaj dhe Misin Thaqi, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumë banesore me afarizëm, Lamela ”A” me etazhitet B+P+8, dhe Lamela “B”, me etazhitet B+P+9”, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 21.03.2022 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit bashkëpronarëve Ilire Ramadani, Osman Maqedonci, Bejtullah Arifi, Nazmi Cubaj, Agron Ramadani, Gani Sheqiri, Shaqir Shaqiri, Fidan Shaqiri, Elmas Isufi, Bashkim Sylaj, Rrahim Zeka dhe Selman Zeka, që të gjithë nga Prishtina me investitor “Lirimi & ACL” me certifikatë të regjistrimit ARBK 810821860 me seli në Prishtinë me përfaqësues Hysen Haxhaj dhe Misin Thaqi, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-120558/21 dt. 25.06.2021, për përdorimin e kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, Lamela ”A” me etazhitet B+P+8, dhe Lamela “B”, me etazhitet B+P+9, të ndërtuara në kuadër të parcelës kadastrale nr. 01521-0, Zona Kadastrale Matičan, të bllokut urban “C-2” të tërësisë “C” të Planit rregullues “Mati 1”, me qasje në rrugën “Rr. “Venet Bajrami”, sipas Vendimit 05Nr.351-70853 dt. 05.10.2013 për lejimin e ndërtimit të kompleksit të ndërtesave dhe plotësim-ndryshimit të Lejes Ndërtimore me numër 05-351-140868 të datës 26.08.2014.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Rr. “Venet Bajrami”, në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Ilire Ramadani, Osman Maqedonci, Bejtullah Arifi, Nazmi Cubaj, Agron Ramadani, Gani Sheqiri, Shaqir Shaqiri, Fidan Shaqiri, Elmaz Isufi, Bashkim Sylaj, Rrahim Zeka dhe Selman Zeka, që të gjithë nga Prishtina me investitor "Lirimi & ACL" me certifikatë të regjistrimit ARBK 810821860 me seli në Prishtinë me përfaqësues Hysen Haxhaj dhe Misin Thaqi, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-120558/21 dt. 25.06.2021, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesat kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, Lamela "A" me etazhitet B+P+8, dhe Lamela "B", me etazhitet B+P+9, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certifikate.

Paraprakisht Drejtorja e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/01-36045/20 dt. 19.04.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njohimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Burim Bajraktari; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Shkelzen Bajraktari; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Raif Shatri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Berat Hasanaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Heset Hajdini; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Arban Shala, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Faton Bajselamni me nr. të licencës 125;

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerik dhe mbrojtjes nga zjarri konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitur në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epor – MMPHI

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-120558/21 DT. 21.03.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit

Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori:

Kristina Sadiqi



